


“Jam Shqiptar” projekti që u mundëson fëmijëve shqiptarë në Diasporë të njohin Shqipërinë



Tashmë çdo fëmijë shqiptar që jeton në Diasporë do të ketë mundësinë ta njohë më mirë Shqipërinë falë projektit “Jam Shqiptar”. Një nismë kjo e Ministrit të Shtetit për Diasporën që do të realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Kulturës bazuar në memorandumit e bashkëpunimit të firmosur mes katër institucioneve. “Jam shqiptar” do t’u mundësojë fëmijëve shqiptarë një program të plotë aktivitetesh për të vizituar më shumë Shqipërinë, me qëllim jo vetëm njohjen e vendit të tyre, por edhe krijimin e lidhjeve mes njëri-tjetrit nën emëruesin e përbashkët “Jam shqiptar”.

Aplikacioni informues “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

FSHZHD dhe IASH nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Instituti “Alb-Shkenca” nënshkruan një marrëveshje për bashkëpunim në fushën e kërkim-zhvillimit dhe të bashkëpunimit me Diasporën shkencore shqiptare. Kjo marrëveshje ka një kohëzgjatje prej tri vitesh dhe përfshin bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor, organizimin e konferencave shkencore, botimeve dhe studimeve në funksion të interesit dhe përfitimit të përbashkët. Aktivitetet bashkëpunuese në kuadër të kryerjes së kërkimit shkencor përfshijnë bashkëpunimin për zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve me interes të përbashkët nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare.

“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



Çdo qytetar shqiptar, brenda dhe jashtë vendit, tanimë ka mundësi të adresojë shqetësimin e tij drejtpërdrejt në të gjitha nivelet drejtuese të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, kjo falë rubrikës më të re “Raporto”, e cila sapo është shtuar në platformën Ambasadalme.

- Për përdoruesit e iOS aplikacioni shkarkohet [këtu](#);
- Për përdoruesit e Android aplikacioni shkarkohet [këtu](#);

Publikohet revista elektronike e Këshillit Koordinues të Diasporës

Publikohet revista elektronike e Këshillit Koordinues të Diasporës, një përmbledhje e plotë e kuadrit ligjor për krijimin e kësaj strukture, e para në historinë e shtetit shqiptar. Në këtë publikim gjendet kuadri ligjor i plotë mbi të cilin është ndërtuar dhe funksionon ky këshill. Gjithashtu edhe një përshkrim mbi karrierën dhe aktivitetin e secilit prej anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Diasporës. Misioni i Këshillit Koordinues të Diasporës është mbrojtja dhe forcimi i marrëdhënieve me Diasporën shqiptare. Këshilli Koordinues i Diasporës është organi përfaqësues i marrëdhënieve të Diasporës shqiptare me institucionet e shtetit të Shqipërisë.



Drejtoresha e QBD-së takim në Konsullatën e Kosovës në Zvicër



Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa, zhvilloi një takim në Konsullatën e Kosovës në Zyrën e Zvicrës me Udhëheqësin e Misionit/ Ministrin Këshilltar z. Sami Kastrati dhe me Konsullin/Këshilltarë znj. Shukrije Ramadani, ku u diskutua rreth politikës së përbashkët për zgjerimin e shkollave shqipe në kantonin e Zyrihut dhe më gjerë, si dhe për një përpjekje të përbashkët për ruajtjen e gjuhës shqipe në brezin e ri të Diasporës shqiptare.

Përfaqësuesit e AKD takim me rektorët e

Universitetit Kombëtar të Radioteknikës në Kharkov



Vizita në Ukrainë. Përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Konsulli i nderit të Shqipërisë në Ukrainë, z. Shahin Omanov zhvilluan një takim me dy rektorët e Universitetit Kombëtar të Radioteknikës në Kharkov. Me ta u diskutua mundësia e krijimit të një projekti bashkëpunimi për përfshirjen e Diasporës shqiptare. Qëllimi i të cilit do të jetë mbështetja e të rinjve të komuniteteve shqiptare kudo në botë për të avancuar njohuritë e tyre në fushën shkencore.

Albanologu i Universitetit të Shën Petërburgut, Aleksandër Novik vizitë në QBD



Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa, zhvilloi një takim me studiuesin dhe albanologun e Universitetit të Shën Petërburgut, Aleksandër Novik, me të cilin u bisedua rreth mundësisë së përkthimit dhe botimit në gjuhën shqipe të veprës “Ekspedita në lumin Azov – Gjuha dhe kultura e shqiptarëve të Ukrainës” vëllimi I, II, me autor kryesor Aleksandër Novik, dhe bashkautorë J. V. Bucatskaja, D. E. Ermolin, A. S. Dugushin, M. S. Morozov (grup autorësh). Ky studim i plotë mbi historinë, gjuhën dhe traditat e shqiptarëve të Ukrainës është vlerësuar me çmimin kombëtar vjetor 2017 nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

Nis shpërndarja e teksteve shkollore falas në Itali dhe SHBA



Teksteve shkollore për mesimdhëniën në Diasporë, të cilat u dërguan nga Qendra e Botimeve për Diasporën kanë filluar të shpërndahen në të gjitha shkollat shqipe SHBA, nën kujdesin e veçantë të ambasadës shqiptare atje. Edhe në Itali ambasada shqiptare ka filluar punën për shpërndarjen e teksteve në shkollat dhe qendrat kulturore ku mbahen mësimet të gjuhës shqipe.

